

TERMAT E REFERENCËS (ToR)

Fasilitatorët

Projekti: *E.H – EmpowHer*

Referenca e projektit: 101193510

Programi: Erasmus+ – ERASMUS-EDU-2024-VIRT-EXCH

Organizata Partnere: Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR), Shqipëri

Koordinatori: Mimma Dreams APS, Trieste, Itali

1. Hyrje

Projekti *EmpowHer – E.H*, bashkëfinancuar nga Programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian, ka për qëllim të promovojë dialogun ndërkulturor dhe të forcojë aftësitë digjitale dhe sipërmarrëse të grave të reja nga zonat rurale të vendeve evropiane dhe të Rajonit 1.

Në këtë kuadër, Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) do të angazhojë fasilitatorë të kualifikuar për të mbështetur zbatimin e aktiviteteve të shkëmbimeve virtuale dhe lokale, duke siguruar pjesëmarrje gjithëpërfshirëse, rezultate cilësore të të nxënimit dhe përputhshmëri me Standardet e Cilësisë të Erasmus+.

2. Qëllimi i detyrës

Fasilitatorët do të luajnë një rol kyç operacional dhe pedagogjik në moderimin, udhëheqjen dhe mbështetjen e pjesëmarrësve gjatë shkëmbimeve virtuale, sesioneve mentorimi dhe aktiviteteve përgatitore lokale të projektit.

Ata do të sigurojnë që të gjithë pjesëmarrësit — veçanërisht gratë e reja nga zonat rurale dhe grupet e pafavorizuara — të jenë të përfshira në mënyrë aktive, të mbështetura dhe të fuqizuara gjatë gjithë procesit të të nxënimit dhe dialogut.

3. Fusha e punës dhe detyrat specifike

Nën mbikëqyrjen direkte të Menaxherit të Projektit të AKR-së dhe në bashkëpunim të ngushtë me partnerin udhëheqës (*Mimma Dreams APS*), fasilitatorët do të kenë përgjegjësitë e mëposhtme:

1. **Fasilitimi dhe moderimi i grupeve**
 - Të menaxhojnë dhe udhëheqin grupe të vogla pjesëmarrësish (maksimumi 20 për fasilitator) gjatë aktiviteteve online, hibride dhe lokale.
 - Të krijojnë një mjedis të sigurt, gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës, që promovon respekt, bashkëpunim dhe mirëkuptim të ndërsjellë.
2. **Nxitja e përfshirjes dhe pjesëmarrjes aktive**
 - Të inkurajojnë pjesëmarrje të barabartë midis të gjithë pjesëmarrësve, pavarësisht gjinisë, kulturës apo gjuhës.
 - Të zbatojnë praktika gjithëpërfshirëse të fasilitimit që sigurojnë vlerësimin e kontributit të secilit.
3. **Dialog dhe ndërmjetësim ndërkulturor**
 - Të lehtësojnë shkëmbime ndërkulturore dhe punë në grup ndërmjet pjesëmarrësve nga kontekste të ndryshme.
 - Të adresojnë me neutralitet dhe ndjeshmëri çdo keqkuptim apo dallim kulturor.
4. **Zbatimi i metodave të të nxënimit jo-formal**
 - Të përdorin metoda pjesëmarrëse e interaktive si brainstorming, mësim ndërmjet bashkëmoshatarëve, mjete digjitale, ushtrime motivuese dhe sesione reflektimi.
 - Të përshtatin qasjen e fasilitimit sipas nevojave të mjedisit digjital dhe ndërkulturor të të nxënimit.
5. **Mbështetje për të nxënimit dhe fuqizimin e grave**
 - Të udhëheqin pjesëmarrëset në kuptimin dhe zbatimin e temave të projektit, përfshirë aftësitë digjitale, sipërmarrjen online dhe fuqizimin e grave.
 - Të nxisin motivimin, vetëbesimin dhe aftësitë drejtuese te gratë e reja nga zonat rurale.
6. **Mbështetje për punëtoritë lokale dhe virtuale**
 - Të kontribuojnë në përgatitjen dhe moderimin e sesioneve lokale përgatitore, aktiviteteve në platforma MOOC dhe forumeve online.
 - Të bashkëpunojnë me stafin teknik dhe të komunikimit të projektit për funksionimin e pandërprerë të shkëmbimeve virtuale.
7. **Monitorimi, dokumentimi dhe raportimi**
 - Të mbledhin dhe dorëzojnë lista prezence, shënime të pjesëmarrjes dhe feedback cilësor pas çdo aktiviteti.
 - Të raportojnë periodikisht tek Menaxheri i Projektit të AKR-së për përfshirje në raportet e monitorimit dhe vlerësimin të projektit.

4. Rezultatet e pritshme

- Fasilitim i suksesshëm i grupeve të caktuara gjatë të gjitha aktiviteteve të *EmpowHer*;
- Dorëzimi i të paktën një raporti fasilitimi për çdo cikël shkëmbimi, që përfshin feedback të pjesëmarrësve dhe rekomandime;
- Plotësimi dhe dorëzimi korrekt i të gjitha dokumenteve mbështetëse (lista prezence, raporte, evidenca), në përputhje me kërkesat e auditimit të Erasmus+.

5. Kohëzgjatja dhe ngarkesa e punës

Fasilitatorët do të angazhohen gjatë fazave të shkëmbimeve virtuale dhe aktiviteteve përgatitore, sipas planit të punës së projektit (2025–2027).

E njëjta skuadër fasilitatorësh do të marrë pjesë në të tre shkëmbimet virtuale (WP2, WP3, WP4), për të siguruar vazhdimësi në mbështetje, mësim dhe cilësi.

Ngarkesa e punës përputhet me planin buxhetor të miratuar për AKR-në në paketat e punës 2–4.

6. Raportimi dhe koordinimi

Fasilitatorët raportojnë drejtpërdrejt tek **Menaxheri i Projektit të AKR-së** dhe bashkëpunojnë ngushtë me koordinuesin e projektit (*Mimma Dreams APS*) për udhëzime metodologjike, përdorimin e mjeteve dhe monitorimin e cilësisë.

7. Kualifikimet dhe kërkesat

- Eksperiencë e dëshmuar në fasilitim, punë rinore ose edukim jo-formal;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe ndërmjetësimi ndërkulturor;
- Njohuri për projektet Erasmus+ dhe mjetet digjitale të të nxënit;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe dhe angleze (me shkrim dhe me gojë);
- Angazhim ndaj parimeve të gjithëpërfshirjes, barazisë gjinore dhe diversitetit.

8. Procesi i Aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë:

- Një CV të përditësuar.
- Një letër motivuese që përshkruan përvojën dhe aftësitë e tyre relevante.
- Aplikimet duhet të dërgohen në **info@rinia.gov.al deri më 05 Maj 2026, në orën 16:30.**

9. Standardet etike dhe të cilësisë

Fasilitatorët do të ushtrojnë detyrat e tyre në përputhje me **Standardet e Cilësisë të Erasmus+, Marrëveshjen e Partneritetit të projektit EmpowHer, dhe Kodit të Etikës së AKR-së**, duke garantuar konfidencialitet, paanshmëri dhe profesionalizëm në çdo moment.

10. Mbikëqyrja dhe pagesa

Mbikëqyrja e zbatimit të detyrave do të bëhet nga **Menaxheri i Projektit – AKR**, i cili miraton përfundimin e tyre përpara çdo pagese.

Pagesa do të kryhet sipas buxhetit të miratuar të projektit dhe pas dorëzimit të të gjitha dokumenteve përkatëse që dëshmojnë realizimin e detyrave.

11. Afati për Aplikime

Aplikimet duhet të dorëzohen deri më 05 Maj 2026, në orën 16:30.

Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR)

"Rruga Naim Frashëri" nr 37, Tiranë, Shqipëri

AKR është një punëdhënëse me mundësi të barabarta dhe inkurajon kandidatët me prejardhje të ndryshme të aplikojnë.

Shënim: Termat e mësipërme të referencës janë një udhëzues i përgjithshëm dhe mund të jenë subjekt i modifikimit sipas nevojave të AKR.